



**BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 6071/2 Prot.

Rrëshen me, 18 . 12 . 2025

V E N D I M

Nr. 97 datë 10.12.2025

P Ë R

**“MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE TË BASHKISË MIRDITË
DHE INSTITUCIONEVE VARTËSE, PËR VITIN BUXHETOR 2026”**

Në mbështetje në ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 23, 32, 33, 54 dhe 64, ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 8, 9, 10, 18 dhe 22, që përcaktojnë rolin e Njesisë Përgjegjëse të Burimeve Njerëzore, në planifikimin e burimeve njerëzore, administrimin e procesit të pranimit, ngritjes në detyrë, vlerësimit dhe lëvizjes paralele, ligji nr. 7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për kategoritë e punonjësve jo shërbim civil në varësi të Bashkisë, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për programimin buxhetor afatmesëm, tavanët e shpenzimeve të personelit dhe rregullat e menaxhimit financiar, për vitin fiskal 2026, Udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike për planifikimin e nevojave të personelit civil dhe raportimin e organikave, relacionin nr. 6071, datë 04. 12. 2025, së bashku me projekt-vendimin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë i cili përcakton kompetencën e Këshillit për miratimin e buxhetit, organikës numerike, pas shqyrtimit në mbledhjen e datës 09. 12. 2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për t’a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Mirditë, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë Mirditë dhe institucioneve vartëse, për vitin buxhetor 2026

Tabela I - Ndarja sipas njësive shpenzuese:

Nr.	Emërtesa e njësisë	Numri punonjësve
1	Aparati i Bashkisë	26
2	Administrata	72
3	Agjencia Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave	28
4	Agjencia e Bujqësisë, ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	45

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

5	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndhmës Sociale	150
6	Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Mirditë	40
7	Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	119
TOTALI		480

2. Numri total i punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin 2026, do të jetë **480** punonjës, këtu përfshihen:

- Kabineti;.....26 nëpunës dhe punonjës
- Administrata;.....72 nëpunës dhe punonjës
- Agjencia Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave;..... 22 punonjës + 6 punonjës zjarrëfikës me buxhet të shtuar, *me shkresën nr. 1002/1 prot, datë 23.10.2025 nga Ministria e Punëve të Brendshme, (DPSHMZSH)*
- Agjencia e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve;.....45 punonjës
- Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes;..... 119 nëpunës dhe punonjës
- Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndhmës Sociale;..... 150 nëpunës dhe punonjës administrative dhe masimor
- Numri i përgjithshëm i punonjësve në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Mirditë;..... 40 punonjës

3. Gjithashtu, për realizimin e plotë të funksioneve të vetëqeverisjes vendore, të përshkruar në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, kreu i VII-të, “Funksionet e vetëqeverisjesvendore”, neni 21, e vijues, Bashkia Mirditë, mund të kontraktojë provizorisht, deri në një afat prej 3 (tre) muajsh një numër punonjësish, të profesioneve apo zanateve të ndryshme deri në 10 (dhjetë) punonjës, për aktivitete kulturore-artistike, sociale, promovime, emergjenca e mbrojtje civile, mjedisi, pyje, mbrojtje nga zjarri etj, të cilat nuk mund të parashikohen, pasi kanë karakter sezonal, të rastësishëm e të paparashikueshëm

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet; Kryetari i Bashkisë, (Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

SEKRETAR
Gasper TOPOLLAJ




KRYETAR
Aleksandër PICAKU





Nr. 6041/1 Prot.

Rrëshen, më. 04 .12.2025

BASHKIA MIRDITË
PROJEKT – VENDIM
KËSHILLIT BASHKIAK MIRDITË

Nr. 104 , datë 04.12 .2025.

**“Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë Mirditë dhe institucioneve
vartëse për vitin buxhetor 2026”**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendorenë RSH-së”, i ndryshuar nenet **23, 32, 33, 54 dhe 64**, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Mirditë i cili përcakton kompetencën e këshillit për miratimin e buxhetit, organikës numerike. **Neneve 8, 9, 10, 18 dhe 22 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**, që përcaktojnë rolin e Njesisë Përgjegjëse të Burimeve Njerëzore në planifikimin e burimeve njerëzore, administrimin e procesit të pranimit, ngritjes në detyrë, vlerësimit dhe lëvizjes paralele. **“Kodi i Punës”**, i ndryshuar I Republikës së Shqipërisë për kategoritë e punonjësve jo shërbim civilë në varësi të bashkisë. **Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë** për programimin afatmesëm buxhetor, tavanët e shpenzimeve të personelit dhe rregullat e menaxhimit financiar për vitin fiskal 2026. **Udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike** për planifikimin e nevojave të personelit civil dhe raportimin e organikave;

VENDOSI:

Tabela 1 - Ndarja sipas njësive shpenzuese

	Emërtesa e njësisë	Numri punonjësve
I	Aparati i Bashkisë	26
2	Administrata	72
3	Agjencia Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave	28

4	Agjencia e Bujqësisë, ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve	45
5	Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndhmës Sociale	150
6	Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Mirditë	40
7	Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes	119
Totali		480

1. Numri i punonjësve të Bashkisë Mirditë për vitin **2026 të jetë 480 punonjës**. Këtu përfshihen:

a) Kabineti : **26** nëpunës dhe punonjës.

* Administrata : **72**, nëpunës dhe punonjës.

* Agjencia Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave : **22** punonjës + **6** punonjës zjarrefikës me buxhet te shtuar me shkresen numër **1002/1.,prot. dt.23.10.2025**. Ministria e Punëve të Brendshme.(DPSHMZSH).

* Agjencia e Bujqësisë, ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve : **45** ing.teknik, punonjës.

* Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes: **119** nëpunës dhe punonjës.

* Agjencia e Arsimit Sportit dhe Ndhmës Sociale **150** nëpunës dhe punonjës administrative dhe masimor.

* Numri i përgjithshëm i punonjësve në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Mirditë, **të jetë 40 punonjës**.

2. Gjithashtu, për realizimin e plotë të funksioneve të vetqeverisjes vendore, të përshkruar në ligjin 139/2015, kreu i VII-të “Funksionet e vetëqeverisjes vendore”, neni 21 e vijues, Bashkia Mirditë, mund të kontraktojë, provizorisht, deri në një afat prej **3** muajsh një numër punonjësish, të profesioneve apo zanateve të ndryshme, deri në 10 punonjës, për aktivitete kulturore-artistike, sociale, promovime, emergjenca e mbrojtje civile, mjedisi, pyje, mbrojtje nga zjarri etj, të cilat nuk mund të parashikohen, pasi kanë karakter sezonal, të rastësishëm e të paparashikushëm.

3. Numri i punonjësve për çdo strukturë organizative, përfshirë administratën qendrore të bashkisë, njësitë administrative, institucionet vartëse dhe njësitë e shërbimeve, të jetë sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë përbërëse e tij.

Sekretari i Përgjithshëm

Artur Lazri


Paraqet Projektin

KRYETARI

ALBERT MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

Nr. 6071 Prot.

Rrëshen, më. 04.12.2025

RELACION SHPJEGUES

Mbi projekt-vendimin "Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mirditë, institucioneve të varësisë dhe njësive administrative"

Për: KËSHILLIN E BASHKISË MIRDITË

Të nderuar këshilltarë!

Kjo kërkesë, për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, për vitin buxhetor 2026, bëhet në një situatë, kur tashmë flitet për një reform të re territoriale në parlament dhe situatën reale të Pushtetit Vendor në Mirditë.

Baza Ligjore

Impakti në buxhetin e Bashkisë do të jetë në përputhje me përcaktimet ligjore për të gjithë pozicionet e punës që do të përfshihen në strukturë. Për këtë do t'i referohemi nenit 54/dhe vijues të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore, të ndryshuar. Nenit 34 e vijues i Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar. Nenit 109 e vijues i Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Nenit 6, 15 e 17 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe ligjin nr. 57/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", të VKM-së nr.328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin

efunksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetqeverisjes vendore”, të ndryshuar me VKM-në Nr. 503, datë 1.8.2024 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetqeverisjes vendore”. VKM-së nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” të ndryshuar me VKM-në Nr. 422, datë 26.6.2024 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave”, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, VKM-së nr. 425, datë 26.06.2024 “Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mesimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”. VKM-së nr. 325, datë 31.5.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike të ndryshuar të ndryshuar me VKM-në nr. 421, datë 26.6.2024, Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.325, datë 31.5.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar”, si dhe të VKM-së nr. Nr. 419, datë 26.6.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” .

RAPORTI SHPJEGUES

Pushtetet e transferuara nga pushteti qendror nuk janë përmbushur me fonde të mjaftueshme për paga dhe shpenzime operative. Shërbimet e arsimit parashkollor (kopshte, çerdhe, Qendra Social-Kulturore të Fëmijëve, mirëmbajtja, ruajtja, pastrimi i objekteve të tyre, personeli jomësimor të të gjitha niveleve, janë transferuar në varësinë tonë dhe ky kalim është shoqëruar dhe me problematikën përkatëse administrative. Po ashtu, Inspektorati Pyjor, mirëmbajtja e Rrugëve Rurale, shërbimi i zjarrfikseve (MZSH), monitorimi i sistemit të vaditjes dhe bordi i kullimit,

tashmë janë pjesë e strukturës tonë dhe përfshihen në këtë numër të përgjithshëm. Njëkohësisht, duhet thënë se strukturat e mëparshme të funksionimit të bashkisë, kanë patur dhe disa mangësi në sinkronizimin e tyre me ligje të ndryshme, që detyrojnë qeverisjen vendore për të patur struktura të tilla, që t'u përgjigjen në zbatimin e këtyre ligjeve. Ligje të tilla si: ligji “Për nëpunësin civil” ligji “Për autoritetet e inspektimit”, ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligji “Për informimin e publikut me dokumente zyrtare”, ligjin “Për deklarin e pasurisë dhe interesave të zyrtarëve të artë”, ligji “Për emergjencat civile” etj, na kanë detyruar të krijojmë struktura të tilla që nuk kanë ekzistuar, por që nevojiten nëpunësit zbatues të këtyre ligjeve, të strukturuar në **“Njësi Përgjegjëse”**.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, i ndryshuar, miratimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve është e drejtë e Këshillit të Bashkisë, ndërkohë që pas dhënies së këtij miratimi, kompozimi i strukturës së Bashkisë është e drejta ekskluzive e Kryetarit.

Nga ana e administratës së Bashkisë po punohet, për hartimin e strukturës së re të Bashkisë, përfshirë edhe Njësitë Administrative. Njëkohësisht në përcaktimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve kanë ndikuar dhe disa realitete të reja që lidhen me ligjin “Për vetqeverisjen vendore” dhe ligjin 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” por edhe ligjeve e akteve të tjera që kanë në fokus reforma të thella jo vetëm përsa i takon reformës territoriale, por në gjithë problematikën social-ekonomike në bashkinë tonë.

Nëpërmjet strukturës së re të projektuar nga titullari i Bashkisë, me të cilën do të realizohen premtimet e programuara, nuk janë patur parasysht “zgjerimet” apo “shkurtimet” e punonjësve por kompozimi i saj, i cili synon të sigurojë një menaxhim më të mirë dhe më efikas, gjithnjë duke patur në fokus interesin publik. Megjithatë, nuk mund të pretendojmë që struktura e menduar dhe kompozuar, **aktuale** e vitit **2024**, në bazë të së cilës është përcaktuar numri i përgjithshëm i punonjësve që po paraqesim, të jetë i përsosur. Kjo dhe për faktin se reforma dhe disa akte të tjera që zgjerojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e qeverisjes vendore, krahas avantazheve, mund të paraqesin dhe disavantazhe për një territor kaq të hapur sa Mirdita, kushtet e saj social-ekonomike, infrastruktura problematike në disa pjesë të territorit të Bashkisë etj. Kjo gjë bën që numri i punonjësve të pakësuar, profesionistët që mungojnë në disa sektorë, ndikon drejtpërdrejt në përkeqësimin e shërbimeve që ofrohen. Ndaj mendoj se duhet të tregohemi “të vëmendshëm” për

të patur një strukturë funksionuese të kompletuar në burime njerëzore, ndonëse drejtësia e këtij veprimi mbetet për t'u provuar.

Ndaj për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave nepërmas strukturave të reja, që do krijohen apo shkurtohen në strukturën e re që do miratohet nga Kryetari, kërkohet natyrshëm ruajtja e numrit të punonjësve.

Në propozimin për numrin e përgjithshëm prej **480** punonjësish, është marrë në konsideratë:

1. **Sigurimin e vazhdimësisë së menjëhershme të funksionimit të administratës së Bashkisë përfshirë edhe Njësitë Administrative.**
2. **Sigurimi i vazhdimësisë së shërbimeve në Qendrën e Bashkisë dhe në Njësitë Administrative.**
3. **Realizimi i funksioneve të transferuara siç përmendëm më lart. Për këtë arsye nevojitet zgjerimi i MZSH me numrin e nevojshëm, Ngritja e Inspektoratit Pyjor, Sektorit për Monitorimin e Rezervuareve e Sistemit të Vaditjes, Sektorit të Emergjencave Civile. (shënim : te struktura e zjarrefikes ka shtesë buxheti për rritjen e numrit të zjarrëfikësve e reflektuar ne numrin e përgjithshëm).**
4. **Krijimi i “Njësive Përgjegjëse” për zbatimin e disa ligjeve (të përmenduar më sipër) të cilat duhen zbatuar në interes të menaxhimit në tërësi dhe interesave publike përkatëse, zyra për Diasporën, zyra e Këshillimit Agro-Bujqësor, trajtimi i kafsheve endacake në qytete etj.**

Për hartimin e numrit punonjësve që nevojiten për strukturën e re të Bashkisë është shfrytëzuar struktura e vitit, **2024** dhe është kërkuar mendimi i çdo drejtorie, pasi ka bërë analizën e punës. Është azhurnuar me ligje ose akte n/ligjore të reja, që prekin ose rregullojnë funksionimin e tyre dhe mbi këtë bazë kanë llogaritur ngarkesën e punës dhe numrin e punonjësve për çdo njësi strukturore. Disa kritere të tjera mbi bazën e të cilave po projektohet struktura e re.

Miratimi i numrit të punonjësve nga ana Juaj dhe strukturës organizative nga Kryetari i Bashkisë, do të vijojë me procedimin sipas ligjit të Shërbimit Civil të lëvizjeve dhe ngritjeve në përgjegjësi e rekrutimit të e punonjësve në bazë të strukturës së re dhe do të sigurojë vazhdimësinë normale të administratës së Institucionit dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve.

Duke ju falenderuar për mbështetjen Tuaj, Ju ftoj t'a votoni propozimin për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve.

Me konsideratën më të lartë!

PARAQITEN RELACIONIN

Sekretari i Përgjithshëm

Artur Lazri



KRYETARI

ALBERT MËLYSHI

